



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT-RAPORTI VJETOR - 2025



PËRMBAJTJA:

1. Hyrje	
1.1. Hyrje	3
2. Veprimtaria e Kuvendit Komunal	
2.1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës.....	4
2.2. Përbërja e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.....	4
3. Përmbledhje e aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit	
3.1. Numri i mbledhjeve të Kuvendit	5
3.2. Numri i pikave të shqyrtuara, diskutuara dhe miratuara,.....	6
4. Përmbledhja e të gjitha Akteve	
4.1. Përmbledhje e Akteve të miratuara sipas muajve dhe mbledhjeve.....	7
4.2. Aktet e Kuvendit të kthyera për Rishqyrtim nga Organi Mbikëqyrës.....	9
5. Plani i Punës së Kuvendit	
5.1. Realizimi i Planit të Punës.....	10
5.2. Sfidat në realizimin e Planit të Punës.....	10
6. Transparenca e Kuvendit	
6.1. Hapja dhe transparenca e proceseve vendimmarrëse	11
6.2. Bashkëpunimi dhe mirëmbajtja e dialogut me shoqërinë civile.....	11
7. Sfidat dhe Problemet Kryesore	
7.1. Identifikimi i sfidave kyçe dhe problematikave	12
7.2. Hapat që janë ndërmarrë për të adresuar këto sfida.....	12
8. Përfundim	
8.1. Prioritetet e planifikuara për vitin 2025.....	13
8.2. Përmbledhje e përgjithshme, komente, sugjerime.....	13

1. Hyrje

Të nderuar dhe të respektuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Prizrenit,

Me kënaqësi ju paraqesim raportin vjetor që përmbledh me kujdes aktivitetet, punët, angazhimet, arritjet dhe sfidat e Kuvendit tonë, për periudhën janar-shtator 2025. Këtë dokument e kemi hartuar me përkushtim dhe synim për të ofruar një pasqyrë të qartë dhe të kompletuar për qytetarët tanë të dashur, duke i njohur ata me punën dhe përpjekjet tona të përbashkëta në shërbim të komunitetit. Raporti ynë ka si synim themelimin e një marrëdhënieje të fortë dhe të hapur me qytetarët tanë të nderuar. Përmes këtij, synojmë të rrisim nivelet e transparencës dhe llogaridhënies duke e bërë të mundur për qytetarët të kenë një panoramë të qartë mbi veprimtarinë dhe vendimmarrjen tonë. Me kujdes dhe përpikëri, kemi dokumentuar hapat tanë drejt përmbushjes së detyrave tona ligjore dhe morale, duke u fokusuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve tanë. Për ne, kujdesi ndaj nevojave të komunitetit dhe angazhimi për zgjidhjen e sfidave janë në qendër të veprimtarisë sonë.

Ju lutemi të gjeni këtë raport si një burim të vlefshëm informacioni të përkushtimit tonë ndaj përmirësimit të jetës së përgjithshme të komunitetit tonë të dashur.

Faleminderit për vëmendjen tuaj të çmuar dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm.

2. Veprimtaria e Kuvendit të Komunës

Në këtë kapitull do të paraqitet veprimtaria e Kuvendit, kompetencat, përgjegjësitë, si dhe përbërja e Kuvendit të Komunës.

2.1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët dhe funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës ka kompetenca dhe përgjegjësi ekskluzive për çështjet vijuese:

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve në çështje të caktuara, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës.

Kuvendi është i obliguar t'i ushtroj detyrat dhe kompetencat sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi në mënyrë sa më transparente karshi publikut.

2.2.Përbërja e Kuvendit të komunës së Prizrenit

Legjislatura aktuale e Kuvendit të Komunës së Prizrenit është zgjedhur nga zgjedhjet lokale të tetorit të vitit 2021.

Komuna e Prizrenit si qyteti i dytë me numrin më të madh të banorëve në Republikën e Kosovës, përbëhet nga 41 anëtarë të Kuvendit, me përfaqësim të dhjetë (10) subjekteve të ndryshme politike.

Në këtë vegëzë gjeni të publikuara në web-faqen e Komunës së Prizrenit anëtarët e Kuvendit, informatat e tyre si dhe kontaktet:

<https://prizren.rks-gov.net/anetar-i-kuvendit/>


3. Përmbledhje e aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit

Në këtë kapitull do të paraqiten të dhënat statistikore për KK-Prizren 2025, siç janë: Numri i mbledhjeve, numri i pikave që janë diskutuar në Kuvend, numri i akteve që janë miratuar, numri i informatave, raporteve dhe të tjera.

3.1. Numri i Mbledhjeve të Kuvendit

Përmes grafikut do të paraqesim numrin e mbledhjeve të Kuvendit:

Grafiku 1: Mbledhjet e Kuvendit




Në këtë vegëzë gjeni të publikuara të gjitha thirrjet e mbledhjeve gjatë vitit 2025:

<https://prizren.rks-gov.net/thirrjet-procesverbalet/?tax=ekstraktet-e-procesverbaleve-te-kuvendit>

3.2.Pika të shqyrtuara, diskutuara dhe miratuara:

Përmes grafikut do të paraqesim numrin e pikave:

Grafiku 2: Pikat..



Në këtë vegëzë gjeni të publikuara të gjitha ftesat e mbledhjeve si dhe materialet që janë shqyrtuara, diskutuara dhe miratuara gjatë vitit 2025:

<https://prizren.rks-gov.net/thirrjet-procesverbalet/?tax=thirrja-per-kuvend>

4. Përmbledhja e të gjitha Akteve

Në vijim do të përmbledhim të gjitha aktet të cilat janë diskutuar dhe miratuar nga Kuvendi i Komunës, gjatë vitit 2025 sipas muajve.

4.1.Përmbledhje e Akteve të miratuara sipas muajve dhe mbledhjeve:

Mbledhja e rregullt – 27 shkurt 2025:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të datës 19 dhjetor 2024 (mbledhjes së rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimin për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm ‘‘Zona e Parkut për Industri të Lehtë në Prizren – Parku i Biznesit’’ sipas Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, sipas kërkesës së MMPHI-së;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Planit për Vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për Komunën e Prizrenit;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e ‘‘Muzeut të Nënës Terezë’’ në Prizren;
8. Raporti financiar për periudhën tetor-dhjetor 2024;
9. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
10. Raporti vjetor për planin e Integritetit për vitin 2024;
11. Raportet e punës të Komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës, për vitin 2024: Komitetit për Politike dhe Financa, Komitetit për Komunitete.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për lejimin e ndarjes së mjeteve në përqindje për projektet bashkëfinansim me fermerë në Komunën se Prizrenit;
13. Diskutim për mundësinë e subvencionimit të dëmit të shkaktuar nga fishekzjarrët në fundvit.

Mbledhja e rregullt - 27 mars 2025:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës: 17 shkurt 2025 (solemne), 27 shkurt 2025 (rregullt), 05 mars 2025 (solemne);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për Transparencë në Komunën e Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Strategjisë për sigurinë në institucionet arsimore në Komunën e Prizrenit;
6. Raporti financiar për periudhën janar-dhjetor 2024;
7. Raporti i komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, për analizim e dëmit të shkaktuar nga fishekzjarrët në fundvit.
8. Raporti i punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2024;

Mbledhja e rregullt – 24 prill 2025

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 27 mars 2025 (e rregullt),
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve dhe tejkalimin e të hyrave vetanake të vitit 2024 në vitin 2025;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për lejimin e mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi aksidental i mjeteve piroteknike në lagjen Bazhdarhane;

Mbledhja e rregullt – 29 maj - vazhduar më 03 qershor 2025:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 24 prill 2025 (e rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraparak mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të Shoqërisë Civile;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores për varrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të reja të Prizrenit në Landovicë;
7. Raporti financiar për periudhën janar-mars 2025;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për plotësimin e listës rezervë sipas vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit për Emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-212080, të datës 15 dhjetor 2016 – Zonave të Qarkullimit Publik në Komunën e Prizrenit.

Mbledhja e rregullt– 30 qershor 2025:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 29 maj 2025 e vazhduar më 03 qershor 2025 (e rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;

Mbledhja e rregullt – 24 korrik 2025

1. Dhënia e betimit nga ana e anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, z. Fatmir Gërdellaj;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për anulimin e vendimit Nr. 001/011-68304, të datës 29 maj 2025, për plotësimin e listës rezervë sipas vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit për Emërtimin e Rrugëve në Territorin e Komunës së Prizrenit, Nr.01/011-212080, të datës 15 dhjetor 2016 zonave të qarkullimit publik në Komunën e Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt planit lokal të veprimit për përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Prizrenit 2025-2028;

6. Raporti gjashtëmujor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025;

Mbledhja e jashtëzakonshme – 25 shtator 2025:

Kjo mbledhje është thirrur me kërkesë të Kryetarit të Komunës, me 2 pika të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2026 si dhe parashikimet për vitet 2027-2028,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e transportit urban.

Mirëpo, për shkak të mungesës së kuorumit, mbledhja nuk filloi dhe u mbyll.

Në këtë vegëzë gjeni të publikuara në web-faqe të Komunës së Prizrenit të gjitha aktet të cilat janë miratuar dhe i'u është konfirmuar ligjshmëria nga organi mbikëqyrës:

Rregulloret: <https://prizren.rks-gov.net/vendimet-rregulloret/?tax=rregulloret-planet>

Vendimet: <https://prizren.rks-gov.net/vendimet-rregulloret/?tax=vendimet>

1.2. Aktet e Kuvendit të kthyer për Rishqyrtim nga Organi Mbikëqyrës

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës është i obliguar që të dërgoj listën e akteve të miratuara për shqyrtim të ligjshmërisë në autoritetin mbikëqyrës. Gjatë vitit 2025, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka nxjerrë akte nga të cilat disa i'u janë kthyer për rishqyrtim nga ana e autoritetit mbikëqyrës (MAPL). Theksohet se Kuvendi i Komunës së Prizrenit, ka përmbushur detyrat e saj në raport me obligimet ligjore dhe në afat ligjor ka përmirësuar aktet e cekura më lartë.

Aktet të cilat janë kthyer në rishqyrtim, janë si vijon:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për plotësimin e listës rezervë sipas vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit për Emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-212080, të datës 15 dhjetor 2016 – Zonave të Qarkullimit Publik në Komunën e Prizrenit.

Në të gjitha mbledhjet e mbajtura të Kuvendit Komunal të Prizrenit ka marr pjesë Kryetari i Komunës, Shaqir Totaj, nënkryetari Kujtim Gashi dhe

varësisht nga kërkesat e kuvendarëve kanë marrë pjesë edhe drejtorët e drejtorive komunale.

5. Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2025

Çdo vit kalendarik, Kuvendi i Komunës duke u bazuar në ligjet dhe akte nënligjore, miraton planin e punës së Kuvendit, në të cilën parashihet mbledhjet që do të mbahen sipas muajve, pushimin vjetor si dhe pikat që duhet të sillen në kuvend për shqyrtim, diskutim dhe miratim. Në vijim do të paraqesim realizimin e planit të punës si dhe ngecjet në realizim.

1.1. Realizimi i Planit të Punës

Plani i punës së KK-Prizren për vitin 2025, ka paraparë të mbahen 07 mbledhje të rregullta për shkak të zgjedhjeve lokale, por duke mos u kufizuar në to. Janë mbajtur 06 mbledhje të rregullta. Po ashtu në agjendën legjislative të vitit 2025 të projekt propozimeve që janë paraparë që të diskutohen, shqyrtohen dhe miratohen nga Kuvendi, mesatarisht janë trajtuar.

1.2. Sfidat në realizimin të Planit të Punës

Sfidat gjatë vitit 2025 kanë qenë kryesisht përshkak të zgjedhjeve lokale si dhe në disa mbledhje ka pasur mungesë kuorumi dhe si rrjedhojë shumica e pikave të parapara në rend dite nuk janë realizuar.

Bashkëlidhur gjeni vegëzën e wep-faqes zyrtare të Komunës, ku gjendet i publikuar plani i punës së Kuvendit:

<https://prizren.rks-gov.net/planet-raportet-e-kuvendit/>

6. Transparenca dhe Llogaridhënia

6.1. Hapja dhe transparenca e proceseve vendimmarrëse

Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2025, ka demonstruar një nivel të lartë të transparencës në procesin e vendimmarrjes, për të siguruar informimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve. Disa aspekte thelbësore që tregojnë transparencën janë si vijon:

- Publikimi i Shpalljeve dhe Njoftimeve:

Kuvendi përmes zyrës për informim ka bërë publike shpalljet dhe njoftimet lidhur me datat e mbajtjes së takimeve nëpërmjet mediave, duke përfshirë faqen zyrtare në internet, rrjetet sociale, portale elektronike, dhe mediat nacionale.

- Transmetimi i Drejtpërdrejtë i Mbledhjeve:

Mbledhjet e Kuvendit transmetohen drejtpërdrejt në rrjetet lokale të televizionit dhe rrjetet sociale. Po ashtu, të gjitha mbledhjet postohen në web-faqen zyrtare të Komunës, duke e bërë shpërndarjen e informacionit më të gjerë dhe të lehtë.

- Publikimi i Dokumenteve të Mbledhjeve:

Të gjitha dokumentet për pikat e rendit të ditës paraqiten në web-faqen e Komunës dhe në rrjetet sociale, duke e mundur qasjen për të gjithë të interesuarit. Ky veprim siguron transparencën dhe hapësirën për vlerësimin dhe komentimin e publikut.

- Publikimi i Akteve të Miratuara nga Kuvendi:

Aktet që miratohen nga Kuvendi dhe konfirmohet ligjshmëria e tyre janë publikuar në mënyrë të hapur në web-faqen zyrtare të Komunës. Ky proces siguron që vendimet e Kuvendit të jenë të njohura publikisht.

Në këtë vegëzë, gjendet i publikuar në web-faqen zyrtare të Komunës rubrika Kuvendi, ku janë të gjitha të punët që bëhen nga Kuvendi:

<https://prizren.rks-gov.net/>, nën rubrika kuvendi.

6.2. Bashkëpunimi dhe mirëmbajtja e dialogut me shoqërinë civile

Organizatave e shoqërive civile kanë dhënë kontribut të vazhdueshëm në fusha të ndryshme, të cilat aktivitete bashkëpunuese kanë qenë të shpeshta edhe me Kuvendin e Komunës gjatë vitit 2025.

Kuvendi ka mbajtur dialog dhe bashkëveprim të rregullt me organizatat e shoqërisë civile. Ndër më të rëndësishmet kanë qenë: Konsultimi Aktiv, Pjesëmarrje në Komisione dhe Grupe Punuese, Komunikimi, etj.

Këto veprime tregojnë përkushtimin e Kuvendit të Komunës së Prizrenit për të qenë transparent dhe për të përfshirë sa më shumë qytetarë në proceset vendimmarrëse.

7. Sfidat dhe Problemet Kryesore

Në këtë kapitull do të paraqesim sfidat dhe problemet që janë trashëguar dhe paraqitur për gjatë vitit 2025, si dhe hapat që janë ndërmarr për t'i zgjidhur ato probleme.

7.1 Identifikimi i sfidave kyçe dhe problematikave

Në listën vijuese do të paraqesim sfidat dhe problematikat e Kuvendit e Komunës për vitin 2025:

1. Mungesa e anëtarëve të kuvendit në mbledhje të Kuvendit, që me raste rezultonte me mungesë të kuorumit për të zhvilluar mbledhjet e Kuvendit,
2. Mungesë e stafit në sektorin e shërbimit të Kuvendit të Komunës,
3. Ngecje e përkthimeve në gjuhët zyrtare të dokumenteve të Kuvendit,
4. Moszbatimi në tërësi i planit të punës së Kuvendit nga ana e kuvendit dhe ekzekutivit.

7.2 Hapat që janë ndërmarrë për të adresuar këto sfida

Përpjekje të vazhdueshme për të zgjidhur sfidat e paraqitura në Kuvendin e Komunës, ka bërë jo vetëm Kryesuesja e Kuvendit, por edhe anëtarët e Kuvendit duke reaguuar përmes seancave dhe formave tjera.

Kryesuesja e Kuvendit në vazhdimësi ka bërë kërkesa drejtuar Kryetarit të Komunës dhe ekzekutivit komunal, në formë verbale dhe me shkrim për zgjidhjen e problemeve që janë paraqitur në funksionimin sa më efikas të Kuvendit si dhe ka dhënë ide, propozime për një zgjidhje të qëndrueshme dhe përfundimtare për probleme të trashëguara dhe aktuale të Kuvendit të Komunës.

8 Përfundim

8.1. Prioritetet e planifikuara për vitin 2026

Një nga prioritetet kryesore të përcaktuara për vitin 2026 për Kuvendin e Komunës sonë është funksionalizimi i plotë në secilën sferë të veprimtarisë së tij.

Funksionalizimi i Kuvendit në secilën sferë ka potencialin të sjellë një ndikim pozitiv të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe zhvillimin e përgjithshëm të komunës sonë.

Në përpjekje për të arritur këtë synim, parashihen të ndërmerren hapa të rëndësishëm, duke përfshirë:

1. Respektimin dhe zbatimin e Ligjeve dhe akteve nënligjore të Republikës së Kosovës,
2. Organizimi i punëtorive, vizitave studimore, trajnimeve për anëtarët e Kuvendit,
3. Përforsimi i transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve,
4. Bashkëpunim më i ngushtë me ekzekutivin komunal.

Me një angazhim të përbashkët në realizimin e këtyre hapa si dhe duke i ruajtur praktikatat e mira të cilat i kemi krijuar në bazë të ligjeve, synojmë që të dalim si një Kuvend më i suksesshëm në nivelin e Republikës së Kosovës, dhe të jemi një model për Kuvendet e Komunave të tjera.

8.2. Përmbledhje e përgjithshme, komente, sugjerime, vërejtje

Ky raport është një përmbledhje e aktiviteteve kryesore që kanë ndodhur në periudhën janar-shtator 2025 në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

Pas diskutimeve të këtij raporti në Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Kuvend të Komunës, planifikohet publikimi i tij në faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit.

Mirëpresim komente, vërejtje dhe sugjerime nga pjesëmarrësit dhe ndjekësit e këtij raporti, pasi që kjo kontribuon në një proces të hapur dhe transparent për të gjithë.

Raporti do të jetë në dispozicion për të gjithë qytetarët në faqen zyrtare të Komunës së Prizrenit, duke theksuar përkushtimin ndaj hapësirës së transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut.

Ju ftojme të ndani mendimet dhe vlerësimet tuaja në lidhje me ngjarjet e raportuara dhe të jeni pjesë e këtij procesi të rëndësishëm për zhvillimin e komunitetit tonë.

Të dhëna për performancë për vitin 2025 si videot për mbledhjet e mbajtura të kuvendit komunal:

1-Kanali i Komunës së Prizrenit në Youtube:

<https://www.youtube.com/@komunaeprizrenit9382/videos>

Janë mbajtur 10 mbledhje

6-Të rregullta

1-Të jashtëzakonshme

3-Solemne

2-Webfaqja zyrtare e Komunës së Prizrenit:

1. <https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/Ftese-per-mbledhjen-e-jashtezakonshme-te-Kuvendit-25-shtator-2025.pdf>
2. <https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Ftese-per-mbledhjen-e-gjashte-te-Kuvendit-24-korrik-2025.pdf>
3. <https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Ftese-per-mbledhjen-e-pestete-te-Kuvendit-30-qershor-2025.pdf>
4. <https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Ftese-per-mbledhjen-Solemne-12-qershor-2025.pdf>
5. <https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Njoftim-per-vazhdimin-e-mbledhjes.pdf> (vazhdim i mbledhjes)
6. <https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Ftese-per-mbledhjen-e-katert-te-Kuvendit-29-maj-2025.pdf>
7. <https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/04/Ftese-per-mbledhjen-e-trete-te-Kuvendit-24-Prill-2025.pdf>
8. <https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Ftese-per-mbledhjen-e-dyte-te-Kuvendit-27-mars-2025.pdf>
9. <https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Ftese-per-mbledhje-Solemne.pdf>
10. <https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/Ftesa-per-mbledhje-Solemne-te-Kuvendit-te-Komunes-dhe-agjenda-per-17-Shkurt-2025.pdf>
11. <https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/Ftesa-per-mbledhje-e-pare-te-Kuvendit-27-shkurt-2025.pdf>

3-Kanali i Komunës së Prizrenit në Youtube:

1. <https://www.youtube.com/watch?v=YYVCUMI9C5g>
2. <https://www.youtube.com/watch?v=VkFO1GZmCzA>
3. <https://www.youtube.com/watch?v=w2xQxw1sOt0>
4. <https://www.youtube.com/watch?v=1wrVquerj3o>
5. <https://www.youtube.com/watch?v=FvbTaPBbros>
6. <https://www.youtube.com/watch?v=s0KtBsZjRx4>
7. https://www.youtube.com/watch?v=40TcrGPuL_o
8. <https://www.youtube.com/watch?v=ifYgvtjD1Q>
9. <https://www.youtube.com/watch?v=Ct34Izy-BbU>
10. <https://www.youtube.com/watch?v=-NpRn80LzrQ&t=808s&pp=0gcJCaIKAYcqIYzv> dhe <https://www.youtube.com/watch?v=76lpcuq4V58>

Kryesuesi i Kuvendit

Antigona Bytyqi